



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.12 datë 16.06.2020

PËR

“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR: ANALIZË E TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE DHE VLERËSIMI TË OFRUESVE TË MUNDSHËM TË SHËRBIMIT UNIVERSAL”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 16.06.2020, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal-dokument përfundimtar”.**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 10, pika 4 e Nenit 13, të Ligjit nr. 46/2015, datë 07.05.2016, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, (**Ligji Nr.46/2015**);
2. Neni 114 dhe 115 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);
3. Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 44/2015**);

4. Pika 2, e nenit 5, të VKM-së Nr. 239, datë 02.05.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”, (*VKM nr.239/2018*).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, si më poshtë:

- a) Dokumentit: “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal-dokument përfundimtar*”;
- b) Relacioni shpjegues i projekt aktit;
- c) Projekt akti i formatuar;

si dhe referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë. Për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në nenin 13 të Ligjit nr. 46/2015, AKEP ndër të tjera ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e shërbimit universal postar, si dhe të mbikqyrë përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar.
2. Bazuar në dispozitat ligjore, AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2581, datë 22.06.2015 ka pajisur subjektin “Posta Shqiptare” sh.a. me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal me afat 5 vjeçar. Në përfundim të këtij afati, AKEP duhet të kryejë procesin e rishikimit të parë, për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit nr. 46/2015. Sipas përcaktimeve të VKD sipërcituar, afati i përfundimit të autorizimit individual të Posta Shqiptare sh.a. për ofrimin e shërbimit universal postar është data 7 korrik 2020.
3. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr.6, datë 16.04.2020, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit: “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, për një afat 30 ditor (17 prill - 18 maj). Ky vendim, pasi u publikua, ju njoftua palëve të interesuara, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, për marrjen e mendimeve përkatëse.

4. Nga palët e interesuara, ka paraqitur mendim vetëm Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet shkresës nr. 3557/1 të datës 14.05.2020. MIE, ndër të tjera, shprehet parimisht dakord me përmbajtjen e dokumentit, duke argumentuar se janë analizuar në tërësi të gjithë aspektet e tregut të shërbimeve postare.
5. Dokumenti përfundimtar “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, përmban një analizë të ecurisë së treguesve të tregut postar në Shqipëri, duke u fokusuar në shërbimin universal, si dhe në vlerësimin e kapaciteteve tekniko-ekonomike të ofruesve aktualë të shërbimit postar, për të ofruar shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 46/2015 dhe akteve nënligjore të tij.
6. Në zbatim të pikës 7 të nenit 6 dhe pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me Urdhërin Nr.469, datë 27.12.2019 “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar”, ka përcaktuar qartësisht shpërndarjen e këtyre pikave të aksesit në territorin e RSH-së, kusht të cilin në përfundim dhe të analizës së kryer e përmbush vetëm ofruesi aktual i shërbimit universal postar.
7. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal-dokument përfundimtar*”, ka konkluduar se në treg ka vetëm një operator, Posta Shqiptare sh.a, që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 10, dhe nenit 13 të Ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin përfundimtar “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të përcaktojë shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a. si ofruesi i vetëm që plotëson kushtet ligjore për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve, të ndjekë procedurat administrative për pajisjen e ofruesit “Posta Shqiptare” sh.a. me autorizimin e ri individual për ofrimin e shërbimit universal postar.
4. Ky vendim dhe dokumenti përfundimtar “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Ketrin Topçiu

Xhoana Lilaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZË E TREGUT
TË SHËRBIMEVE POSTARE
DHE
VLERËSIMI TË OFRUESVE TË MUNDSHËM TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Dokument Përfundimtar

(MIRATUAR ME VKD NR.12, DATE 16.06.2020)

PËRMBATJA:

Tabela e Përmbajtjes

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6

II. HYRJE.....	9
II.1. Struktura e dokumentit	9
II.2. Kuadri ligjor dhe rregullator	10
II.3. Ofruesit e shërbimeve postare	12
III. Analiza e tregut të Shërbimeve Postare	17
III.2. TREGUESIT FINANCIARË	22
III.4. TREGUESIT TEKNIK DHE TE RRJETIT	29
III.5. CILËSIA DHE STANDARTET E REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE	30
III.6. TË PUNËSUARIT	32
III.7. ANKESAT E PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA	34
IV. Ofrimi i shërbimi universal postar nga Posta Shqiptare	36
V. Vlerësimi ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal postar.....	53
V.1 KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E OFRUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR	54
VI. Përfundime	57
Aneks 1- Pyetjet e Këshillimit Publik.....	58

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ligji Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar, si dhe organet përgjegjëse për rregullimin e sektorit. Një fokus i veçantë në ligjin 46/2015 i kushtohet sigurimit të shërbimit universal postar në gjithë territorin e RSH sipas kërkesave specifike të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

Sipas nenit 64, pika 3 e Ligjit, AKEP pajisi Posta Shqiptare sh.a. me autorizim individual për ofrimin e shërbimit universal me afat 5 vjeçar, dhe në përfundim të këtij afati AKEP kryen procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas përcaktimeve të nenit 13 të ligjit. AKEP, në mbështetje të këtij përcaktimi ligjor, me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur ofruesin “Posta Shqiptare sh.a”, me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Sipas përcaktimeve të VKD 2581/2015 të AKEP, afati i përfundimit të autorizimit individual të Posta Shqiptare për shërbimin universal postar përfundon më 7 Korrik 2020.

Ky dokument përbën analizën e tregut postar dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”.

Dokumenti përmban një analizë të ecurisë së treguesve të tregut postar në Shqipëri, duke u fokusuar në shërbimin universal si dhe në vlerësimin e kapaciteteve tekniko-ekonomike të ofruesve aktualë të shërbimit postar për të ofruar shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015 dhe akteve nën-ligjore të tij.

Dokumenti pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim Nr.6, datë 16.04.2020 – *Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”*, ju njoftua palëve të interesuara, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës si dhe u publikua për këshillim publik nga data 17 prill-18 maj 2020.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 3557/1 të datës 14.05.2020 shprehet se “pas shqyrtimit të dokumentit *“Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”*, vëren se janë analizuar në tërësi të gjithë aspektet e tregut të shërbimeve postare duke u shprehur parimisht dakord me përmbajtjen e dokumentit.

MIE në vijim kërkon që në procesin e rinovimit/dhënies së autorizimit individual për shërbimin universal postar të mbahen parasysh respektimi i detyrimeve për pikat e aksesit përcaktuar në urdhërin nr. 469, datë 27.12.2019 të Ministrit “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar” si dhe kërkesat ligjore për cilësinë e shërbimit dhe përmbajtja e rekomandimeve/detyrave të lëna nga AKEP në kuadër të inspektimeve të kryera pranë Postës Shqiptare që janë prezantuar në dokumentin e analizës.

Nga dokumenti përfundimtar i analizës e tregut të shërbimeve postare potencialisht rezulton se Posta Shqiptare SHA plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin, sipas parashikimeve të VKM nr.239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar”.

Nga analiza përfundimtare rezulton se në treg ka vetëm një operator që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, Posta Shqiptare Sh.A.

Për këto arsye, AKEP-i do të miratojë zgjatjen e afatit të autorizimit individual të operatorit ekzistues Posta Shqiptare SHA për sigurimin e shërbimit universal postar dhe do të mirtoj autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. HYRJE

Ky dokument është përgatitur nga AKEP në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për shërbimet postare në RSH”, nenit 64 ku përcaktohet se AKEP-i kryen procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, në përfundim afatit 5 vjeçar të autorizimit individual që ka “Posta Shqiptare”, sh.a si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar sipas vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2581, datë 22.06.

Në kreun e parë të dokumentit përshkruhet në mënyrë të përgjithshme rëndësia e shërbimeve postare në zhvillimin ekonomik të vendit dhe lidhjet me tregjet e tjera në kushtet kur tregtia komerciale dhe shërbimet e tjera financiare po kërkojnë gjithnjë e më shumë mbështetje në tregun e shërbimeve postare.

Në kreun e dytë paraqitet baza ligjore dhe rregullatore mbi të cilën AKEP realizon analizën e tregjeve të shërbimeve postare dhe miratimin e autorizimit për shërbimin postar universal.

Kreu i tretë i referohet analizës së tregut përkatës të shërbimeve postare ku rezulton se Posta Shqiptare, edhe si ofrues i shërbimit universal gjatë viteve të fundit, determinon tregjet përkatëse.

Në kreun e katërt është analizuar plotësimi i kriterëve ligjore dhe rregullative nga ana e Postës Shqiptare sipas raportimeve të përvitshme pranë AKEP dhe rezultatet e inspektimeve që ka realizuar AKEP pranë Postës Shqiptare SHA sa i përket shërbimit universal.

Në kreun e pestë është analizuar numri i ofruesve potencialë të shërbimit universal postar sipas kriterëve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore.


Aneks 1 përmban pyetjet për këshillimin publik për të cilat nuk është shprehur asnjë nga palët e interesuara.

II.1. Struktura e dokumentit

Shërbimet Postare janë të një rëndësie të veçantë strategjike në zhvillimin ekonomik të vendit si dhe për nevojën e domosdoshme të komunikimit konsumator – konsumator (C2C), biznes – biznes (B2B), biznes - konsumatorë (B2C) si dhe anasjelltas (C2B).

Rëndësia dhe pozicionimi i sektorit të shërbimeve postare është paraqitur në figurën në vijim në të cilën sektori i shërbimit postar konsiderohet si urë ndërlidhëse e tri tregjeve shumë të rëndësishme dhe vitale si: tregut të komunikimeve elektronike, tregut të marketingut/reklamave dhe tregut të transportit/logjistikës së mallrave.

Figura 1: Pozicioni strategjik i sektorit postar (Industrië Postare) në tregun e përgjithshëm



Burimi: UPU research on postal market

Gjithashtu, shërbimet postare dhe sektori i shërbimit postar janë të një rëndësie jetike për konsumatorët biznes dhe konsumatorët e tjerë, dhe për komunikimin mes tyre dhe konsiderohet si një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik.

Tregjet postare vitet e fundit po marrin një zhvillim të shpejtë, në ndërlidhje të përbashkët me zgjerimin e tregjeve të komunikimeve elektronike, marketingut/reklamave dhe tregtisë elektronike.

II.2. Kuadri ligjor dhe rregullator

Referuar Ligjit Nr.46/2015 “Për shërbimet postare në RSH”, çdo përdorues, në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e shërbimit universal postar, që përfshin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit postar me një cilësi të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit brenda territorit të tyre.

Shërbimi universal postar përfshin kërkesat minimale të mëposhtme:

- pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e objekteve postare që peshojnë deri në 2 kg;
- pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e pakove postare që peshojnë deri në 10 kg;
- shërbimet për objektet postare të regjistruara dhe objektet postare të siguruar.

Pavarësisht nga kufiri i peshës për pakot postare, i përcaktuar sipas Ligjit, ofruesi/t e shërbimit universal postar duhet të sigurojnë që objektet postare, të pranuar në një vend anëtar të BE-së dhe që peshojnë deri në 20 kg, të shpërndahen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shërbimi universal postar mbulon shërbimet postare brenda vendit, si dhe ato ndërkuftare.

Ofruesi/it e shërbimit universal sigurojnë shërbimin universal për çdo përdorues, të paktën në 5 ditë në javë, duke ofruar, minimalisht, me përjashtim të rrethanave ose kushteve gjeografike, të cilat konsiderohen të jashtëzakonshme:

a) pranimin e objektit postar;

b) shpërndarjen e objektit postar në banesë ose në ambientet e çdo personi fizik apo juridik

AKEP, në mbështetje të nenit 64 pika, 3 e Ligjit nr. 46/2015, me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur ofruesin “Posta Shqiptare SHA”, me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.

Posta Shqiptare SHA ka detyrim të ofrojë shërbimin universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të Autorizimit Individual si dhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të sektorit postar.

Në plotësim të kërkesave të nenit 65 të ligjit 46/2015 për nxjerrjen e akteve nënligjore të sektorit postar, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës ka nxjerrë:

- Urdhrin nr. 469, datë 27.12.2019, "*Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar*", duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Udhëzimin nr.4038, datë 4.09.2015, “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, i cili përcakton detyrimet e ofruesit të shërbimit universal për ofrimin e objekteve postare cekograme pa pagesë për personat e verbër ose pjesërisht të verbër.

AKEP, në zbatim të nenit 64 të ligjit 46/2015 ka miratuar paketën e plotë rregullatore të ofrimit të shërbimeve postare, pjesë e së cilës është dhe Rregullorja nr. 36 datë 29.10.2015 “Për ofrimin e shërbimit universal postar”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.2627, datë 29.10.2015 në të cilën janë përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga rrjeti postar i një ofruesi të shërbimit universal, me qëllim përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit postar.

Sipas kërkesave të Autorizimit Individual Posta Shqiptare duhet të zbatojë:

1. *Detyrimin e ofrimit të shërbimit universal postar çdo përdoruesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, duke përshirë shërbimet postare brenda vendit dhe ndërkombëtare.*
2. *Organizimin e rrjetit postar me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar sipas kërkesave të ligjit 46/2015 dhe akteve rregullatore të miratuara nga AKEP për ofrimin e shërbimit universal postar.*
3. *Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar;*

4. Parimet për përcaktimin e tarifave dhe kostove për ofrimin e shërbimit universal postar.

Për sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar, AKEP-i mund të caktojë:

- a) një ose më shumë ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar, për sigurimin e elementeve të veçanta të një shërbimi universal postar, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen;
- c) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për mbulimin e zonave të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen në zonën përkatëse. Zona minimale e territorit për përcaktimin e një ofruesi të shërbimit universal postar përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përcaktimi i ofruesit/esve të shërbimit universal postar bëhet me vendim të AKEP-it, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit universal postar, duke konsideruar rolin e rëndësishëm që shërbimi universal postar luan për shoqërinë, si dhe duke siguruar trajtimin e barabartë të përdoruesve në gjithë territorin.

Në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar AKEP-i, në veçanti, merr në konsideratë:

- a) rrethanat dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe nevojën e zbatimit të shërbimit universal postar;
- b) aftësitë teknike, përfshirë sistemin e informacionit, për ndjekjen e objekteve postare, financiare dhe besueshmërinë e ofruesit për sigurimin e shërbimit universal postar në një zonë të caktuar ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të përcaktuar;
- c) pikat e aksesit të rrjetit postar të ofruesit të shërbimit universal postar;
- d) kostot përkatëse neto, për ofrimin e shërbimit universal postar, si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit, që mund të kërkohej nga operatori për ofrimin e shërbimit universal postar.

II.3. Ofruesit e shërbimeve postare

Sipas Legjislacionit në fuqi, shërbime postare në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të ofrojnë çdo person fizik ose juridik kundrejt autorizimit nga AKEP. Kriteret dhe kushtet e detajuara për autorizim për ofrimin e shërbimeve postare janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit 46/2015, si dhe në rregulloret përkatëse:

- 1) Rregullore Nr. 38 datë 19.11.2015 për “Autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”; dhe
- 2) Rregullore Nr. 36 Datë 29.10.2015 “Për ofrimin e shërbimit universal postar”
- 3) Nga regjistri i ofruesve të shërbimeve postare evidentohet se deri më datë 06.04.2020 janë gjithsej 17 ofrues shërbimi postar aktiv që ofrojnë shërbime postare në Republikën e Shqipërisë

Tabela 1. Ofruesit e shërbimeve postare

Nr	Ofruesi i shërbimeve postare	Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit	Shërbimet postare të regjistruara	Data e deklarimit të fillimit të shërbimeve postare
1	Posta Shqiptare SHA	Nr.2015-AISHP-0018 Dt. 05.01.2016	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit; b. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Postë direkte.	12.1.1999
2	DHL International (Albania) SHPK	Nr.2015-APSHP-0029 Dt. 08.01.2016	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Shërbim postar me vlerë të shtuar.	29.12.2015
3	T.N.T Express Albania SHPK	Nr.2015-APSHP-0103 Dt. 08.01.2016 Nr.2016-APSHP-00019 Dt. 30.05.2016 (Shtim shërbimi)	a. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Postë direkte. e. Shërbim jo universal postar brenda vendit; f. Postë me shumicë; g. Postë hibride.	07.01.2016 01.06.2016

4	Albanian Courier SHPK (A.C.)	Nr.2015-APSHP-0051 Dt. 06.01.2016 Cregjistruar me kerkese Nr. 2020- APSHP-00062 date 24.01.2020	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit; b. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Postë direkte; f. Postë hibride; g. Postë me shumicë.	05.1.2016
5	Albanian Cargo Service SHPK (A.C.S.)	Nr.2015-APSHP-0067 Dt. 06.01.2016	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit; b. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit; c. Shërbim postar ekspres brenda vendit; d. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; e. Postë direkte; f. Postë hibride; g. Postë me shumicë.	05.1.2016
6	United Transport SHPK (Uni Trans)	Nr.2015-APSHP-0049 Dt. 07.01.2016	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit, b. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit, c. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit, d. Shërbim postar ekspres brenda vendit, e. Postë direkte (e paadresuar), f. Postë me shumicë brenda vendit, g. Postë hibride.	05.1.2016
7	Ulysses Enterprises SHPK (Fedex)	Nr.2015-APSHP-0121 Dt. 11.01.2016	a. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; b. Shërbim postar ekspres brenda vendit.	08.1.2016
8	Sky Net Logistic SHPK	Nr.2015-APSHP-0050 Dt. 06.01.2016 Cregjistruar me kerkese Nr. 2019- APSHP-00054 date 24.12.2019	a. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit.	05.1.2016
9	Albanian Delivery Express SHPK	Nr.2015-APSHP-0016 Dt. 05.01.2016	a. Shërbim postar ekspres brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit; c. Postë direkte.	22.7.2014
10	Youth Albania Professional Services	Nr.2015-APSHP-0017 Dt. 05.01.2016	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres	29.12.2015

	(YAPS)		brenda vendit; c. Postë direkte.	
11	RAD MAIL SHPK	Nr.2015-APSHP-0108 Dt. 08.01.2016 Cregjistruar sipas kerkeses me nr. Reference: 2020- APSHP-00057 datë 21.01.2020	Nr.2015-APSHP-0108 Dt. 08.01.2016 a. Shërbim jo universal postar brenda vendit; b. Shërbim postar ekspres brenda vendit; c. Postë direkte.	08.1.2016
12	FAST-DELIVERY SHPK	Nr.2017-APSHP-00022 Datë 09.10.2017 Cregjistruar sipas kerkeses me nr. Reference: 2019- APSHP-00053 datë 22.11.2019	a. Shërbim jo universal postar brenda vendit, b. Shërbim jo universal postar me jashtë vendit, c. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit, d. Shërbim postar ekspres brenda vendit, e. Shkëmbim i dokumentave, f. Postë direkte (e paadresuar), g. Postë hibride.	09.10.2017
13	E-KOMPLET SHPK	Nr.2018-APSHP-00023 datë 22.06.2018	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres me jashtë vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	01.07.2018
14	COEX SHPK	Nr. 2018-APSHP-00025 datë 08.10.2018	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	01.10.2018
15	ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION SHPK	Nr. 2018-APSHP-00039 datë 19.10.2018	a.Postë direkte (e paadresuar), b.Shërbim postar ekspres brenda vendit, c.Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	22.10.2018
16	SPEED COURIERS ALBANIA (Albi Shkurta –person fizik)	Nr. 2019-APSHP-00041 datë 28.01.2019	a) Postë direkte (e paadresuar), b) Shërbim postar ekspres brenda vendit c) Shërbim jouniversal postar brenda vendit d) Shërbim i shkëmbimit të dokumentave e) Postë me shumicë f) Postë hibride	04.02.2019

17	INTEX COURIER SHPK	Nr. 2019-APSHP-00049 datë 19.09.2019	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	01.10.2019
18	TURBOO ALBANIA SHPK	Nr.2019-APSHP-00047 datë 19.09.2019	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	20.09.2019
19	PANORAMA GROUP SHA	Nr.2019-APSHP00051 datë 29.10.2019	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit	02.12.2019
20	FLASH DELIVERY ALBANIA	Nr.2020-APSHP00061 datë 27.01.2020	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	17.02.2020
21	Balkan Courier & Logistics sh.p.k.	Nr.2020-APSHP00063 datë 03.04.2020	a. Postë direkte (e paadresuar), b. Shërbim postar ekspres brenda vendit, c. Shërbim jouniversal postar brenda vendit.	06.04.2020


Burimi: AKEP (Rregjistri për Shërbimet Postare-Përditësuar datë 06.04.2020)

III. Analiza e tregut të Shërbimeve Postare

AKEP-i kryen analizën e tregut postar dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr.46/2015**) dhe VKM Nr. 239, datë 2.5.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”, bazuar në të dhënat statistikore dhe financiare periodike të dërguara nga ofruesit si dhe mbi informacionet e administruara nga procedurat e inspektimeve.


Në analizën e kërkesave teknike minimale për shërbimin universal postar, AKEP-i bën vlerësimin e tyre sipas neneve 12, 13, e 14, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Grafik 1. Ecuria e shërbimit universal postar



Siç shihet dhe nga grafikët e mësipërm, në shërbimin universal postar pjesën më të madhe të tregut e zotëron posta brenda vendit, e cila luhatet rreth 90% për vitet 2015-2018, duke u shoqëruar me një rënie të kësaj pjese në rreth 80% gjatë vitit 2019.

Grafik 2. Mbulimi i tregut për shërbimin universal postar, postë ndërkombëtare kundrejt postës brenda vendit



Në grafikun e mësipërm paraqiten pjesët e tregut në përqindje që mbulojnë objektet postare brenda vendit dhe objektet postare ndërkombëtare mbi totalin e objekteve postare të shërbimit Universal Postar.

TË DHËNA MBI SHËRBIMIN JOUNIVERSAL POSTAR

Tabela 2. Shërbimi jouniversal postar Posta Shqiptare vs.Operatorët e tjerë

	Posta Shqiptare		Operatorët e tjerë		Totali
	Postë brenda vendit	Postë ndërkombëtare	Postë brenda vendit	Postë ndërkombëtare	
2016	2,479,064	6,534	167,275	11,408	2,664,281
2017	2,603,017	9,702	277,504	34,632	2,924,855
2018	2,819,601	6,616	490,900	35,486	3,352,603
2019	1,486,594	7,389	655,796	39,769	2,189,548

Burimi: Të dhëna nga operatorët, përpunimi AKEP


Në këtë tabelë paraqiten të dhënat për objektet e thjeshta dhe të regjistruara për katër vitet e fundit 2016-2019.

Tabela 3. Shërbimi jouniversal postar, mbulimi i tregut postar brenda vendit vs.ndërkombëtar

	Postë brenda vendit		Postë ndërkombëtare	
	Posta Shqiptare	Operatorët e tjerë	Posta Shqiptare	Operatorët e tjerë
2016	93.0%	6.3%	0.2%	0.4%
2017	89.0%	9.5%	0.3%	1.2%
2018	84.1%	14.6%	0.2%	1.1%
2019	67.9%	30.0%	0.3%	1.8%

Në shërbimin jo universal postar, në postën brenda vendit Posta Shqiptare SHA zotëron pjesën më të madhe të tregut, ndërsa në postën ndërkombëtare ndodh e kundërta, operatorët e tjerë zotërojnë tregun me mbi 60% të totalit të postës ndërkombëtare. Ndryshim ka pasur gjatë vitit 2019 Operatorët e tjerë kanë rritur pjesën e tregut si për postën brenda vendit ashtu edhe për postën ndërkombëtare.

Grafik 3. Shërbimi jo universal postar në total, mbulimi i tregut P.SH. vs. Op.tjerë




Edhe pse operatorët e tjerë zotërojnë tregun me mbi 60% të totalit të postës ndërkombëtare, tregu i shërbimit jo universal postar në total për katër vitet e fundit 2016-2019 zotërohet nga Posta Shqiptare me mbi 84% të tregut.


III.1. NDARJA E TREGUT TË SHËRBIMIT POSTAR EKSPRES

Sipas Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” “Shërbim ekspres” është shërbimi i shpërndarjes “derë me derë”, në një kohë të shkurtër, shpërndarjes një ditë pas dorëzimit, ose transportit në kohë të përcaktuar të objektit postar që përfshin shpërndarjen e dokumenteve, pakove dhe mallrave. “Shpërndarje” është procesi i përpunimit në qendrën e shpërndarjes për dorëzimin e objekteve postare në destinacion.

Grafik 4. Shërbimi ekspres Posta Shqiptare vs. Operatorët e tjerë




Grafik 5. Shërbimi ekspres, mbulimi i tregut Ekspres brenda vendit vs. Ekspres ndërkombëtar




Në shërbimin ekspres, dominojnë operatorët e tjerë mbi Posta Shqiptare SHA. Në postën ekspres brenda vendit kanë më shumë se 60 % të tregut krahasuar me 40 % që ka Posta Shqiptare SHA. dhe në shërbimin ekspres ndërkombëtar zotërojnë mbi 88% të totalit të këtij shërbimi ndaj 12 % të Posta Shqiptare SHA.

Grafik 6. Shërbimi ekspres, mbulimi i tregut Posta Shqiptare vs Operatorë të tjerë



Siç vihet re në këtë grafik tregu i shërbimit ekspres zotërohet nga operatorët e tjerë me që varion nga 63% -76 % të totalit.

Grfaik 7. Shërbimi ekspres në total, ecuria në vite




Nga grafiku i mësipërm vihet re se shërbimi ekspres në vitin 2017 ka pësuar një rënie me 4 % ndërkohë që në dy vitet 2018 – 2019 volumi i shërbimit ekspres ka pësuar rritje rreth 50%.


Me VKM¹ Nr.542 datë 27.07.2016, blerjet online me vlerë të produktit mbi 22 euro taten me tarifë doganore dhe TVSH, me përjashtim të alkoolit, duhanit dhe parfumeve, të cilat taten në çdo rast, pavarësisht vlerës së blerjes, pra edhe nëse ajo është më e vogël se 22 euro. Para vitit 2016, tarifa doganore dhe TVSH-ja zbatoheshin vetëm mbi blerjet dhe dërgesat mbi 150 euro.

Grafik 8. Mbulimi tregut Posta Shqiptare vs Operatorë të tjerë për të gjitha shërbimet e ofruara, universal, jouniversal dhe ekspres

¹ PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.919, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË LIGJIT NR.102/2014, DATË 31.7.2014, "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"



Grafik 9. Totali i objekteve postare të dërguara nga P.SH dhe Of. e tjerë, ecuria në vite



Nga grafiku i mësipërm vihet re Posta Shqiptare në të gjitha shërbimet e ofruara, të mara së bashku ka zotëruar për 5 vitet e fundit mbi 90 % të tregut.

III.2. TREGUESIT FINANCIARË

Sipas Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, ofruesit e shërbimeve postare, që ofrojnë shërbime postare, kanë raportuar pranë AKEP-it informacione

financiare, dhe statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që rrjedhin nga një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare.

Informacioni i kërkuar dhe administruar nga AKEP-i është proporcional me përmbushjen e detyrave funksionale, për të cilat është kërkuar, dhe AKEP jep arsyet, për të cilat ky informacion është kërkuar.

Të dhënat e përditësuara në këtë dokument përfundimtar tregojnë se shërbimi universal ka gjeneruar pjesën kryesore të të ardhurave për Postën Shqiptare dhe të ardhurat nga shërbimi universal kanë ardhur në rritje të vazhdueshme gjatë katër viteve të fundit. Për vitin e fundit financiar 2019, të ardhurat nga shërbimi universal ishin mbi 1.3 miliardë lekë gjatë që përbën një rritje prej 3.5 për qind krahasuar me vitin 2018.


TË ARDHURAT E POSTA SHQIPTARE SHA

Tabela 4. Të ardhurat e gjenerura në vite sipas shërbimeve të ofruara

	Shërbimi Universal	Shërbimi Jo Universal	Shërbimi Ekspres
2016	940,639,439	45,335,044	203,141,704
2017	1,111,556,572	27,304,556	204,914,226
2018	1,173,414,067	25,952,080	204,030,000
2019	1,304,029,955	12,451,045	216,162,060

Nga grafiku vihet re se **burimi kryesor i të ardhurave të Postës Shqiptare sa i përket shërbimit postar (pa përfshirë të ardhurat nga shërbimet financiare) është shërbimi universal postar me mbi 85% pjesë tregu**, i ndjekur nga shërbimi ekspres dhe shërbimi jouniversal postar.

Grafik 10. Ndarja e të ardhurave sipas shërbimeve të ofruara



III.3. NDARJA E TREGUT MES POSTËS SHQIPTARE DHE OFRUESIT E TJERË

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2019² nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,36 miliardë Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,532,643,060 Lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total 825,295,157 Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar


² Të dhënat financiare për vitin 2019 sipas raportimeve të sipërmarrësve të shërbimeve postare

në të ardhurat për vitet 2016 - 2019. Posta Shqiptare zotëron 65% të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 24% dhe me pas nga ofruesit e tjerë.

Tabela 5. Të ardhurat e gjenerura në vite, Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë


Viti/te ardhurat (leke)	Posta Shqiptare	Ofruesit e tjerë
2015	1,085,696,584	1,000,615,916
2016	1,189,116,187	890,320,818
2017	1,343,775,354	979,436,426
2018	1,403,396,147	735,103,734
2019	1,532,643,060	825,295,157

Grafik 11. Pjesët e tregut në të ardhura, Posta Shqiptare vs .Ofruesit e tjerë



Edhe gjatë vitit 2019, vërehet se Posta Shqiptare si dhe operatorët e tjerë kanë shënuar rritje të të ardhurave krahasuar me vitin 2018, kjo ka bërë që pjesa e tregut të të ardhurave të Postës Shqiptare të shkojë në rreth 65% nga rreth 66% që ishte në vitin 2018.

Grafik 12. Të ardhurat në total, ecuria në vite




Për sa i përket të ardhurave në total, grafiku i mësipërm na tregon se në vitin 2016 ka pasur një rënie të lehtë të të ardhurave me rreth -0.3%. Ndërkohë që në vitin 2017 ka pasur një rritje me 12 % në vitin 2018 vihet re një rënie e lehtë prej 8% dhe në vitin 2019 ka pasur një rritje me 10%.

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2019 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,3 miliard Lekë, me një rritje prej rreth 10 % në krahasim me vitin 2018. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,5 miliard lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total rreth 825 milionë lekë.

Pjesa e tregut në të ardhura e Postës Shqiptare në vitin 2019 ishte rreth 65% që është dukshëm më ulët se pjesa e tregut në volumin e objekteve postare prej 90%. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2019.

NDARJA E TREGUT SIPAS TË ARDHURAVE


Grafik 13. Ndarja e tregut në të ardhura nga të gjithë ofruesit e shërbimeve postare



Posta Shqiptare zotëron 65 % të tregut dhe ka shënuar rritje me 9% të të ardhurave nga shërbimet postare krahasuar me vitin 2018, ndërkohë DHL kompania e dytë me pjesën më të madhe në treg gjatë vitit 2019 ka pësuar rritje me rreth 176% të të ardhurave nga shërbimet postare në krahasim me vitin 2018. Gjatë vitit 2019 kanë shënuar rritje në të ardhura operatorët Sky Net Logistic dhe YAPS përkatësisht me 6% dhe 8%, ndërkohë që operatorët TNT United Transport kanë shënuar rënie në të ardhura me rreth 15% në krahasim me vitin 2018. Operatorët e tjerë kanë pjesë tregu më të vogla se 3%.

POSTA SHQIPTARE – SHËPRNDARJA E TË ARDHURAVE SIPAS SHËRBIMEVE

Grafik 14. Shpërndarja në të ardhura sipar shërbimeve të ofruara



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP


Të ardhurat nga shërbimet postare për Postën Shqiptare kanë shënuar rritje me rreth 9% krahasuar me vitin 2018, ku pjesën më të madhe e përbëjnë të ardhurat nga Shërbimi Postar Universal.

III.3. INVESTIMET NË SEKTORIN POSTARE

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e të ardhurave dhe investimeve në sektorin postar në vitet 2015-2019. Në vitin 2019 totali i investimeve në sektorin postar ishte 19 milion Lekë, me një rënie prej rreth 90% në krahasim me vitin 2018.

ECURIA E TË ARDHURAVE DHE INVESTIMEVE

Grafik 15. Të ardhurat dhe investimet në total, ecuria në vite



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP


INVESTIMET NGA POSTA SHQIPTARE DHE OFRUESIT E TJERË

Tabela 6. Invesimet në vite nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë

	Investimet	
	Posta Shqiptare	Ofruesit e Tjerë
2015	111,330,345	24,365,600


2016	194,715,354	32,945,133
2017	128,478,797	122,978,483
2018	147,792,668	45,549,289
2019	528,640	18,635,829

Grafik 16. Pjesët e tregut në investime, Posta Shqiptare vs.Ofruesit e tjerë



Ashtu si të ardhurat, edhe në investime, sic mund të shihet edhe nga grafiku i mësipërm, Posta Shqiptare zotëron një përqindje të lartë deri në vitin 2018, ndryshe ndodh në vitin 2019 ku Posta Shqiptare mbulon vetëm 3% të totalit të investimeve.

Grafik 17. Investimet në total, ecuria në vite



Për sa i përket ecurisë së investimeve në vite, ndryshe nga të ardhurat, në vitin 2016 vihet re një rritje e ndjeshme me rreth 68%, në vitin 2017 një rritje e moderuar me 10% e shoqëruar me një rënie me rreth 23% në vitin 2018 dhe me një rënie të theksuar me 90% në vitin 2019.


III.4. TREGUESIT TEKNIK DHE TE RRJETIT

Sipas Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, AKEP harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar, në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë standardet për ofrimin e shërbimit universal postar.

Ofrimi i shërbimeve postare bëhet në përputhje me standardet e harmonizuara europiane dhe standardet ndërkombëtare për shërbimet postare, të përcaktuara nga UPU-ja. Në rrjetin postar mund të vendosen vetëm pajisje që kanë karakteristika teknike, sipas standardeve të harmonizuara e të miratuara nga organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë aderon. Informacioni mbi standardet e aplikueshme për shërbimet postare publikohet në faqen zyrtare të AKEP-it.

Grafik 18. Treguesit teknik dhe të rrjetit, ecuria në vite

Treguesit teknik dhe të rrjetit



	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun (qendra përpunimi)	Numri i automjeteve të transportit	Numri i sporteve për shërbime Universale	Kuti postare për pranim	Kuti postare për dorezim
2015	995	28	619	597	0	0
2016	892	47	581	654	565	606
2017	901	47	567	684	528	609
2018	1,006	49	649	700	537	667
2019	1,032	51	751	416	1,246	667

III.5. CILËSIA DHE STANDARTET E REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE POSTARE

Një nga qëllimet e Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” është edhe përcaktimi i standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimit universal, nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit, harmonizimi i standardeve teknike dhe modernizimi i shërbimeve postare.

AKEP-i, me rregullore, përcakton standardet për cilësinë e shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit me cilësi të mirë, sipas standardeve ndërkombëtare. Ofruesit e shërbimit universal postar janë të detyruar, të paktën një herë në vit, të publikojnë informacion për cilësinë e shërbimit universal postar. Cilësia e shërbimit përfshin, në veçanti, kërkesa për kohën e shpërndarjes së objekteve postare, sistemin e informimit për ndjekjen e objekteve postare, rregullsinë dhe besueshmërinë e shërbimeve kombëtare dhe ato ndërkufitare/ndërkombëtare. Monitorimi i cilësisë së shërbimeve kryhet nga AKEP-i, të paktën një herë në vit. Rezultatet e monitorimit publikohen në faqen zyrtare të AKEP-it. Në rast mosrespektimi të cilësisë së shërbimit nga ofruesi i shërbimit universal postar, AKEP-i njofton ofruesin e shërbimit, duke i vendosur afat për përmirësimin e detyrimeve. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përsëritura, AKEP-i merr masa të përshkallëzuara, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në bazë të nenit 64, pika 3 e Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, AKEP ka pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e Shërbimit Universal në Republikën e Shqipërisë, Personin Juridik “Posta Shqiptare sha”.

Në bazë të rregullores nr.36 datë 29.10.2015 “Për ofrimin e Shërbimit Universal Postar” miratuar me VKD Nr.2627, Datë 29.10.2015, standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit të ofruar nga Posta Shqiptare janë:³

³ D: data e depozitimit (pranimit) të objektit postar në (nga) ofruesi i shërbimit postar.

n: numri i ditëve të punës (përfshihen ditët e pushimit dhe festat zyrtare) që duhen për shpërndarjen e objektit nga data e pranimit deri në datën e dorëzimit tek i adresuari.

Tabela 7. Standardet e cilësisë për shërbimin universal postar brenda vendit - Posta Shqiptare

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje sipas afatit)
Brenda për brenda qytetit	D + 1	95%
	D + 2	5%
Ndërmjet qyteteve	D + 1	85%
	D + 2	15%
Në fshatra	D + 2	60%
	D + 3	20%
	D + 4	20%

Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar të ofruar nga Posta Shqiptare janë:

Tabela 8. Standardet e cilësisë së shërbimit universal postar ndërkombëtar - Posta Shqiptare

	Afati Kohor i shpërndarjes (D+n)	Objektivi (në përqindje kumulative)
Vendet e BE (Poste Europe) dhe rajonit SEE ¹	D + 3	85%
	D + 5	97%
Vendet e Tjera (UPU):		
Vendet e Rajonit të Mesdheut (përveç vendeve të BE)	D + 5	85%
Vendet e Amerikës së Veriut	D + 6	85%
Vendet e tjera të Amerikës, Azi dhe Oqeani	D + 8	85%
Vendet Afrikës	D + 9	85%

Tabela 9. Standardet e cilësisë së Shërbimit Universal Postar 2016-2019

	Postë brenda vendit							Postë ndërkombëtare					
	Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra			Vendet e BE (Europë)			Vendet e tjera (UPU)		
	D+1	D+2	D+1	D+2	D+2	D+3	D+4	D+3	D+5	D>5	D+5	D>5	
2016	96.1%	3.9%	94.9%	5.1%	82.0%	14.1%	3.9%	92.4%	7.6%	0%	0%	0%	
2017	95.7%	4.3%	94.5%	5.5%	77.2%	19.6%	3.2%	85.1%	97.3%	100%	0%	0%	
2018	96.3%	3.7%	95.2%	4.8%	77.7%	20.0%	2.3%	85.1%	97.3%	100%	0%	0%	
2019	96.5%	3.5%	95.3%	4.7%	80.9%	19.1%	0.0%	n/a	n/a				

Në bazë të rregullores nr.38 datë 19.11.2015 “Për Autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e Shërbimeve Postare” miratuar me VKD Nr.2643, Datë 19.11.2015, ofrimi i shërbimeve postare duhet të realizohet në përputhje me standardet europiane dhe ato botërore për shërbimet postare, si dhe me standardet e përcaktuara nga AKEP në këtë rregullore.

Standardet e cilësisë për shërbimin postar brenda vendit të ofruar nga ofruesi i shërbimit postar janë:

Tabela 10. Standardet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – postë brenda vendit

Detyrimet e cilësisë së shërbimeve postare ekspres – brenda vendit			
Brenda për brenda qytetit/ Ndërmjet qyteteve		Në zonat rurale	
Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara	Koha e dorëzimit	Objekte postare të dorëzuara
D + 1	95 %	D + 2	5 %

Për dërgesat ekspres të postës së jashtme mund merren në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimit postar të ofruesve të shërbimit postar me të cilat është lidhur marrëveshje.


Ofruesi i shërbimit postar ka detyrimin e plotësimit të standardeve të mëposhtme të shërbimit postar të CEN të transpozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) e Shqipërisë:

- S SH EN 13850:2012:** Shërbimi postar – Cilësia e shërbimit – Matja e kohës së tranzitit të shërbimeve nga fillimi në fund (end-to-end) për pjesë të veçanta të dërgimit prioritar me postë dhe dërgimi me postë i klasit të parë;
- S SH EN 14508:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për një pjesë jo prioritare të dërgimit me postë dhe dërgimi me postë i klasit të dytë;
- S SH EN 14534:2006:** Shërbimet postare - Cilësia e shërbimit - Matja e kohës tranzite nga fillimi në fund i shërbimit për dërgesat me postë me grumbuj të pa ambalazhuar.


III.6. TË PUNËSUARIT

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun në vijim vihet re se në vitin 2019 Posta Shqiptare mbulon mbi 83% të totalit të të punësuarve në sektorin postar.


Grafik 19. Raporti i të punësuarve, Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë- viti 2019



Grafik 20. Numri i të punësuarve nga cdo ofrues i shërbimeve postare, ecuria në vite



Grafik 21. Numri i të punësuarve Posta Shqiptare vs. Ofruesit e tjerë, ecuria në vite



Gjatë vitit 2019 bazuar në raportimet e operatorëve postarë rezulton se numri i të punësuarve në sektorin postar është 2,933 punonjës, që përbën një rritje me 340 punonjës krahasuar me vitin 2015. Rritjen më të madhe e kanë shënuar operatorët e tjerë me 197 punonjës. Pjesa e tregut të Postës Shqiptare përsa i përket numrit të punonjësve ka pësuar rënie nga rreth 88% në vitin 2015 në rreth 83 % në vitin 2019.


III.7. ANKESAT E PRANUARA DHE TË ZGJIDHURA

Sipas Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, ofruesit e shërbimeve postare hartojnë kushtet e përgjithshme dhe termat e ofrimit të shërbimeve postare, të cilat, në veçanti, përmbajnë edhe procedurat për zgjidhjen e ankesave.

Çdo përdorues i shërbimeve postare ka të drejtë të ankohet apo të kërkojë sqarime tek ofruesi i shërbimit postar, në rast se vëren shkelje në përmbushjen e termave dhe kushteve të përgjithshme të ofrimit të shërbimit postar, të tarifave të ofruara nga ofruesi i shërbimit postar, si dhe të cilësisë së shërbimit të ofruar. Përdoruesi i shërbimit postar mund të paraqesë ankimin me shkrim brenda 30 ditëve: a) nga ofrimi i shërbimit, nëse ankesa i referohet cilësisë së shërbimit të ofruar; b) nga marrja e faturës për shërbimin e ofruar, nëse ankesa i referohet shumës së faturuar për shërbimin e ofruar. Pas marrjes së ankesës, ofruesi i shërbimit postar duhet të verifikojë ankesën e bazuar në pikën 3 të nenit 37, dhe, pas verifikimit, të kthejë një përgjigje jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së ankesës nga përdoruesi i shërbimit postar. Nëse përdoruesi nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të ofruesit të shërbimit postar, atëherë përdoruesi fillon procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas nenit 55 të Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë. Çdo ofrues i shërbimit postar është i detyruar të publikojë, në faqen zyrtare të tij dhe në zyrat e ofrimit të shërbimit, rregullat për pranimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve, sipas Ligjit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e numrit të ankesave të pranuar dhe të zgjidhura nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë në periudhën 2015 – 2019.

Grafik 22. Ankesat e pranuarra vs. të zgjidhura, ecuria në vite



Nga të dhënat e raportuara, vërehet se për vitin 2019 numri i ankesave ka qenë 1,179 dhe të gjitha rezultojnë të zgjidhura. Ndërkohë, që shuma e dëmit të kompensuar shkon rreth 1,308,297 lekë.

IV. Ofrimi i shërbimi universal postar nga Posta Shqiptare

IV.1. AUTORIZIMI INDIVIDUAL PËR SHËRBIMIN UNIVERSAL

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.46 datë 07.05.2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, AKEP me Vendimin Nr.2581, datë 22.06.2015 i ka dhënë Postës Shqiptare autorizimin individual, si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar, me afat pesëvjeçar.

Ofruesi i Shërbimeve Postare “Posta Shqiptare” SHA është i pajisur me Autorizimin Individual për Ofrimin e Shërbimit Universal në Territorin e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2581, datë 22.06.2015, si dhe i pajisur me Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit Nr. 2015-APSHP-0018, datë 05.01.2016 për ofrimin e shërbimeve postare sipas rregjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.


Ky afat përfundon në datën 7.7.2020 qershor 2020 dhe për këtë arsye AKEP sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, ka filluar procedurën e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimin nëse ka më shumë se një ofrues të mundshëm të shërbimit universal postar.

Sipas ligjit ligjit Nr. 46. Datë 07/05/2015, “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”: çdo përdorues, në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e shërbimit universal postar, që përfshin ofrimin e vazhdueshëm të shërbimit postar me një cilësi të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga AKEP-i dhe me çmime të përballueshme në të gjitha pikat e aksesit brenda territorit të tyre.

Në zbatim të ligjit AKEP ka vlerësuar:

- a) Nëse ka apo jo zona të pambuluara me shërbim nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar;

AKEP ka publikuar hartën e mbulimit me shërbim nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar me 559 zyra postare për të mbuluar me shërbim gjithë zonat gjeografike.



b) Nëse ka apo jo elemente të shërbimit universal të paofruara nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar.

Posta Shqiptare ofron të gjithë elementët e shërbimit universal ku përfshihen objektet postare si:

LETRAT

Konsiderohet letër çdo komunikim i shkruar që përbën një korrespondencë zyrtare ose personale, e mbyllur në zarf, i cili ka formën e një drejtkëndëshi. Mbi zarf nga ana e përparme e tij, në të dhjathtë shkruhet adresa e marrësit, ndërsa në pjesën e përparme në të majtë shkruhet adresa e dërguesit.

Adresa e marrësit dhe e dërguesit duhet të jetë e plotë dhe e saktë, e lexueshme, e shkruar me gërma kapitale romake dhe shifra arabe. Letrat pranohen me peshë deri në 2 kg si për brenda ashtu edhe për jashtë vendit.

PAKETAT E VOGLA

Quhen paketa të vogla, objektet që përmbajnë sende të ndryshme në sasi të vogël, prodhime artistike, disqe gramafoni, shirita manjetike, cigare, mostra tregtie, ose ndonjë send tjetër që

shërben si mostër, pjesë këmbimi aparaturash etj. Në këto paketa nuk lejohen të futen kartmonedha ose sende të tjera me vlerë.

Duhet t'i kushtohet rëndësi ambalazhimit të paketës, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për formën dhe përmbajtjen e saj. Pesha e paketës duhet të jetë deri në 2 kg si brenda ashtu edhe për jashtë vendit.

KARTË POSTARE

Kartë – postaret mund të jenë të thjeshta, të cilat janë të përbëra prej kartoni të hollë ose prej letre të trashë 90x140mm dhe kartë postaret me përgjigje të paguar, të cilat përbëhen nga dy karta postare të thjeshta të palosura njëra mbi tjetrën, me ndryshim që ajo e poshtme ka të shkruar mbishkrimin “Përgjigje Paguar”.

Njëra anë e kartës postare të thjeshtë është e pastër, ku dërguesi mund të shkruajë korrespondencën, adresën e marrësit. Përsa i përket kartës postare me përgjigje të paguar, kjo e fundit i dorëzohet marrësit pa u shkëputur pjesët e saj.

CEKOGRAMET

(OBJEKTE POSTARE PER TE VERBERIT) Cekogramet janë korrespondenca për të verbërit, të cilët sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbërve, Shoqata e të Verbërve në Shqipëri, udhëzimit Nr. 4038 datë 04/09/2015 dhe rregullave të UPU-së, përfitojnë shërbim postar falas. Objektet postare për të verbërit përfshijnë:

- korrespondencën, literaturën për të verbërit dhe pjesërisht të verbërit të çfarëdo lloji formati (edhe regjitrime me zë).
- pajisje apo materiale të çfarëdo lloji të përshtatura për të ndihmuar personat e verbër dhe pjesërisht të verbër në lehtësimin e problemeve të shikimit.

Kufiri i peshës për këtë kategori objekte, si për brenda ashtu edhe për jashtë vendit është 7 kg.

FTESAT, KOMUNIKIMET DHE LAJMËRIMET GJYQËSORE

Ftesat, komunikimet dhe lajmërimet gjyqësore janë objekte, të cilat dërgohen nga institucionet e drejtësisë, në zarfe, ose të hapura dhe trajtohen si objekt i porositur. Këto objekte përbëhen nga dy pjesë, pjesa e parë zë vendin e lajmërim marrjes dhe e dyta i dorëzohet marrësit.

IV.2 PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NGA POSTA SHQIPTARE PËR SHËRBIMIN UNIVERSAL

Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” kreu i VII, neni 33 “Cilësia e shërbimit” dhe Rregullores “Për ofrimin e shërbimit Universal Postar”, miratuar me Vendimin Nr.2627, datë 29.10.2015 të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Kreu VIII “Standardet e Cilësisë së Ofrimit të Shërbimit Universal” neni 31, Posta Shqiptare Sh.A. ka raportuar çdo vit pranë AKEP mbi cilësinë e shërbimit universal.

Grafik 23.Cilësia dhe standartet e shërbimit universal postar, viti 2019

- Në rishikimin e grafikëve të brendshëm të grumbullimit, përpunimit ,vijimit të objekteve postare të shërbimit universal dhe shpërndarja e tyre sipas destinacionit .
- Në masat e marra nga kontrollet periodike në Filiale dhe Degë në varësi në lidhje me përmirësimet në organizimin e brendshëm të punës brënda zyrës postare, sektorëve të shërbimeve të degëve dhe filialeve .

Në formë tabelare treguesit e planifikuar për çdo filial sipas standardeve paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 11.Cilësia e shërbimit universal postar, objektivat e performancës për vitin 2019

OBJEKTIVAT E TREGUESVE TË PERFORMANCËS SË CILËSISË SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR VITI 2019

Nr.	FILIALI	Standarti i miratuar (D+1) %	Objektivi treguesit te performances cilesise brenda qyteti (D+1) %	Standarti i miratuar (D+1) %	Objektivi treguesit te performances cilesise ndermjet qyteteve (D+1) %	standarti i miratuar (D+2) %	Objektivi treguesit te performances cilesise ndermjet fshatrave (D+2) %
		a	d = (b x c)	a		a	d
1	Filiali Tiranë		96.0		94.1		79.2
2	Filiali Durrës		98.0		97.0		86.5
3	Filiali Elbasan		97.1		96.3		78.3
4	Filiali Shkodër		96.0		94.6		77.4
5	Filiali Lezhë		96.1		95.6		78.3
6	Filiali Fier		95.1		95.1		80.1
7	Filiali Vlorë		95.1		93.1		76.6
8	Filiali Lushnjë		97.0		97.5		86.5
9	Filiali Berat		95.1		95.1		78.3
10	Filiali Korçë		95.1		93.1		76.6
11	Filiali Gjirokastrë		96.0		94.1		74.0
12	Filiali Sarandë		96.0		89.3		76.6
13	Filiali Mat		92.7		86.5		70.6
14	Filiali Kukës		94.1		93.1		70.6
15	Qendra Tranzite				100.0		
	KOMPANIA D+I	95.0	95.6	85.0	94.3	60.0	77.8

Sipas standardeve të miratuara, Degëve të shërbimeve të Filialeve ju dërguan evidencat statistikore mujore për treguesit e cilësisë të shërbimit universal postar të ripunuara për vitin 2019, në zbatim të Rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”. Evidencat statistikore për treguesit e cilësisë të shërbimit universal postar u përgatitën sipas standardeve të shërbimit universal dhe destinacionit të objekteve postare :

- Evidenca mujore për standardin e shërbimit universal **brënda qytetit**
- Evidenca mujore për standardin e shërbimit universal **ndërmjet qyteteve**
- Evidenca mujore për standardin e shërbimit universal **ndërmjet fshatrave**

Posta Shqiptare Sh.A. me shkresën Nr.119 dt.15.01.2019 miratoi planin mbi organizimin e testeve të brëndshme me objekt letrën e thjeshtë dhe rekomande për matjen e cilësisë së shërbimit të brendshëm në përputhje me standardet e shërbimit universal postar.

Testet e brëndshme të realizuara në Filiale dhe Degë me panelistë në të gjitha qytetet e vendit tonë janë një instrument matës për cilësinë e brendshme të shërbimit universal postar brënda qytetit, ndërmjet qyteteve dhe ndërmjet fshatrave.

Gjatë vitit 2019, Sektori i Cilësisë të Standardeve të Shërbimit Universal pranë Drejtorisë së Sigurimit dhe Cilësisë zhvilloi trajnime me punonjësit në Filiale dhe Degë në lidhje me standardet e shërbimit, realizimin e objektivave të treguesve të cilësisë të shërbimit universal postar.


☐ Rezultatet e testeve të brëndshme për vitin 2019 paraqiten si më poshtë vijon :

❖ Organizimi i Testeve të brendshme brenda qytetit

Nga data 04 – 16 Mars 2019, u zhvilluan dy teste për matjen e cilësisë së shërbimit universal postar brenda qyteteve. Testi me objekt letrën e thjeshtë u zhvillua gjatë periudhës 04-09 Mars dhe testi me objekt letrën rekomande nga 11-16 Mars. Nga përpunimi i materialeve të testeve rezultoi:

U përpunuan 408 copë objekte test letra të thjeshta dhe 408 cope objekte test letra rekomande. Për të dy testet shpërndarja e objekteve test sipas ditëve paraqitet si më poshtë:

	Standardi	Fakti 2019
▪ D + 1	95.0 %	100.0 %
▪ D + 2	5.0 %	0.0%



Gjatë kontrollit të materialeve të testeve me objekt letrën e thjeshtë dhe rekomande, ndërmjet panelistëve brenda qyteteve u konstatuan përmirësime në drejtim të zbatimit të grafikëve të brendshëm të grumbullimit dhe shpërndarjes së postës nga zyrat postare, plotësimi korrekt i zarfave, kartave të kontrollit. U konstatua në disa raste, vula datare të padallueshme në disa teste me objekt letrën e thjeshtë dhe rekomande në disa data 11,13.03.2019 të degës Pogradec, Shkodër, Mat, Delvinë, Vlorë, Durrës, Shijak, Berat. Rezultatet e testit tejkaluan standardin e miratuar nga A.K.E.P..

❖ Organizimi i Testeve të brendshme ndërmjet qyteteve

Nga data 03–08 Qershor 2019 u zhvillua testi me objekt letrën e thjeshtë me panelistë ndërmjet qyteteve, për matjen e cilësisë të proceseve të pranimit, grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes të objektit postar dhe zbatimit të rregullores bazë të shërbimit postar. Nga përpunimi i materialeve të këtij testi rezultoi:

U përpunuan 6709 copë objekte test letra të thjeshta. Shpërndarja e tyre sipas ditëve paraqitet si më poshtë:


Në D+1 u shpërndanë 6476 copë letra test ose 97.0 % e totalit.

Në D+2 u shpërndanë 166 copë letra test ose 2.5 % e totalit.

Mbi D+2 u shpërndanë 67 copë letra test ose 0.5 % e totalit.

Krahasuar me standardin dhe rezultatin e testit të letrës së thjeshtë për vitin 2018 rezultatet paraqiten :

	Standardi	Fakti 2018	Fakti 2019
D + 1	85.0%	99.73 %	97.0 %
D + 2	15.0%	0.24 %	2.5 %
Mbi D + 2		0.03 %	0.5 %



Standardi i shërbimit është tejkaluar në masën 12% , ndërsa krahasuar me realizimin e vitit 2018 ka ulje në masën 2.7 % . Në uljen e rezultatit në D+1 ndikuan këta faktorë:

- **Mos vijimi i testeve brenda ditës së postimit sipas grafikut të vijimit të dërgesave postare .**

- Ju tërhoq vemendja zyrove postare pjesmarrëse në testim respektivisht : Peshkopi, Librazhd, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Lushnjë, për mosvijimin e disa objekteve postare test brenda ditës së postimit për në zyrën qendër Filiali, Dege për tu vijuar në Qendrën Tranzite, duke sjellë ulje të rezultatit të testit të cilësisë në normativën D+1, krahasuar me një vit më parë.

Rezultatet e testit tejkaluan standardin e miratuar nga A.K.E.P..


- ❖ Organizimi i Testeve të brendshme ndërmjet fshatrave

Nga data 30 Shtator - 05 Tetor 2019 u zhvillua testi me objekt letrën e thjeshtë me panelistë ndërmjet fshatrave, për matjen e cilësisë së shërbimit universal postar, të proceseve të pranimit, grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes dhe zbatimit të rregullores të shërbimit universal postar. Nga përpunimi i materialeve të këtij testi rezultoi: U përpunuan 6513 copë objekte test letra të thjeshta. Shpërndarja e tyre sipas ditëve paraqitet si më poshtë:

- Në D+2 u shpërndanë 5731 letra test ose 88.0 % e totalit.
- Në D+3 u shpërndanë 696 letra test ose 10.7 % e totalit.
- Në D+4 u shpërndanë 86 letra test ose 1.3 % e totalit.

Krahasuar me standardin e miratuar, rezultati i testit të letrës së thjeshtë për vitin 2019 paraqitet:

	Standardi	Viti 2019
• D + 2	60 %	88.0 %
• D + 3	20 %	10.7 %
• D + 4	20 %	1.3%



Nga përpunimi i materialeve të testit , rezulton se në testin e letrës së thjeshtë standardi i miratuar D+2 60% është realizuar në masën 88 %, për rrjedhojë rezultati i testit është më i lartë se standardi i miratuar nga A.K.E.P..

Nga data 30 Shtator - 05 Tetor 2019 u zhvillua testi me objekt letrën rekomande me panelistë ndërmjet fshatrave, për matjen e cilësisë së proceseve të pranimit, grumbullimit, përpunimit,

shpërndarjes dhe zbatimit të rregullores të shërbimit universal postar. Nga përpunimi i materialeve të këtij testi rezultoi:


U përpunuan 6097 copë objekte test letra rekomande. Shpërndarja e tyre sipas ditëve paraqitet si më poshtë:

- Në D+2 u shpërndanë 5468 letra test ose 89.7 % e totalit.
- Në D+3 u shpërndanë 548 letra test ose 9.0 % e totalit.

Krahasuar me standardin e miratuar, rezultati i testit të letrës rekomande për vitin 2019 paraqitet:

	Standardi	Viti 2019
• D + 2	60 %	89.7 %
• D + 3	20 %	7.9 %
• D + 4	20 %	2.1 %

Nga përpunimi i materialeve të testit, rezulton se në testin e letrës rekomande standardi i miratuar D+2 60% është realizuar në masën 89.7%.




Nga analiza e materialeve të testit rezultoi se ka disa parregullsi në : vijimin me vonesë të objekteve postare dhe dorëzimi me vonesë të tyre në disa zyra postare fshat, si rrjedhojë e moszbatimit me korrektësi të grafikëve të brendshëm, plotësimi jo korrekt i kartave të kontrollit dhe plotësimit të pasqyrave analitike dhe përmbledhëse të treguesve të shërbimit. Për këto probleme ju tërhoq vemendja sektorëve të shërbimit të filaleve dhe degëve në varësi : Kukës, Peqin, Malësi e Madhe, Vlorë, Bulqizë Berat, Skrapar, Laç, Librazhd , Mirditë, Pukë.

Rezultatet e testit tejkaluan standardin e miratuar nga A.K.E.P..

❑ Posta Shqiptare Sh.A. pjesmarrëse në testet e jashtme të projektit G.M.S. të monitoruara nga UPU –ja

Posta Shqiptare Sh.A. gjatë vitit 2019 mori pjesë në projektin **G.M.S. (Global Monitoring System)** të monitoruar nga UPU-ja, për matjen e cilësisë së shërbimit universal postar nëpërmjet shkëmbimit të testeve me objekt letrën e thjeshtë të vijuar me rrugë ajrore, me tre operatorë postarë pjesëmarrës në këtë projekt, në modulën E2E Internal.

- Shkëmbimi i testeve të vazhduara të këtij moduli u krye sipas planeve të përcaktuara nga menaxherët e projektit për shkëmbimin e testeve ndërmjet panelistëve me tre operatorë postarë përkatësisht : Kroaci, Itali, Maqedoni e Veriut.
- Panelistët pjesmarrës në këtë projekt ishin nga filialet Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë. Testet u shkëmbyen me transpondera të dhënat e të cilëve u hodhën në sistemin G.M.S. sipas planit ditor të gjeneruar nga sistemi .
- Gjatë vitit 2019, standardet e shërbimit universal postar në segmentet e vendit tonë janë realizuar në D+1.
- Performanca e treguesve të cilësisë të testeve G.M.S. për vitin 2019 ndërmjet Posta Shqiptare sh.a. dhe operatoreve postar të lartpërmendur, paraqiten si më poshtë vijon



Për sa më lart standardet E2E janë realizuar në linkun me Kroacinë ndërsa nuk janë realizuar në linkun me Italinë dhe Maqedoninë e Veriut për shkak të vonësave në territoret respektive të operatorëve postarë. Standardi brenda territorit të vendit tonë është realizuar D+1.

❑ Projekti “Shko Gjellbër me një flotë të modernizuar dhe ekologjike”

Posta Shqiptare Sh.A. gjatë vitit 2019 në kuadrin e strategjisë për mbrojtjen e mjedisit, të lançuar në Kongresin e 21-të të U.P.U.-së (Seul 1994) dhe në Axhendën për vitin 2030 “ Për një zhvillim

të qëndryshëm”, të përkrahur nga operatorët postarë anëtarë të U.P.U.-së, të cilat janë thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet Konceptoi: Përgj.Sek.Cil. E. Shtylla

Miratoi : Drejt.Drejt.Sig.Cil F. Salku

Konfirmoi: Drejtor i Dep. Zhvill.dhe Stand.V.Andoni

e globit për një partneritet Global, duke sugjeruar që çdo administratë postare duhet të luajë një rol aktiv në mbrojtjen e mjedisit”, hartoi dhe aplikoi në Sekretariatit e Bordit të Q.S.F. (Fondi i Shërbimeve të Cilësisë) pranë Unionit Postar të Përbotshëm (U.P.U.), projektin për përmirësimin e treguesve të cilësisë së shërbimit postar si më poshtë vijon:

Projekti **“Shko Gjellbër me një flotë të modernizuar dhe ekologjike”**. Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e flotës të Postës Shqiptare me 12 furgonë eko –miqësor dhe 6 stacione karikimi E.V.

Projekti do të implementohet në katër Filiale :

- Filiali i Qendrës Tranzite do të paiset me 7 furgona eko –miqësor të cilët do të transportojnë dërgesat postare në shtatë linjat kryesore
- Filiali Tiranë do të paiset me 3 furgona elektrik
- Filiali Durrës do të paiset me 1 furgon elektrik
- Filiali Vlorë do të paiset me 1 furgon elektrik

Qëllimi i këtij projekti është fuqizimi i flotës së transportit të dërgesave postare të Posta Shqiptare Sh.A. me automjete ekologjike, në kuadër të mbështetjes së direktivës të U.P.U.-së për mbrojtjen e mjedisit global ku theksohet se një ndër shkaqet e ndotjes së mjedisit në proceset operacionale postare është flota e automjeteve të çdo operatori postar.

Për të zvogëluar ndikimin negativ të dyoksidit të karbonit në mjedisin global, operatorë të ndryshëm postarë anëtarë të U.P.U.-së kanë filluar të marrin masa për të minimizuar këtë problem, kanë filluar investimet në fuqizimin e flotave me automjete ekologjike.

Posta Shqiptare Sh.A., si operatori i vetëm publik në vendin tonë, me qëllimin e ofrimit të shërbimeve postare për të gjithë përdoruesit sipas standardeve të cilësisë të miratuara nga A.K.E.P. në përputhje me standardet e U.P.U.-së dhe PostEuropës, me mbështetjen e Fondit të Shërbimit të Cilësisë (Q.S.F.) pranë U.P.U.-së, do të realizojë projektin : “Shko Gjellbër me një flotë të modernizuar dhe ekologjike” QSFALB1803. Ky projekt do të mundësojë rinovimin me 20% të flotës së transportit aktual e cila është me parametra teknikë jo bashkohor .

Ky projekt ka nisur në maj të 2019 dhe brenda vitit 2020 do të realizohet faza e testimit të automjeteve duke realizuar përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës të cilësisë të këtij shërbimi në vendin tonë.

Posta Shqiptare Sh.A., ndër objektivat kryesore në strategjinë e punës, ka patur përmirësimin e vazhdueshëm të Cilësisë së Shërbimit Universal Postar në funksion të ofrimit, sigurimit dhe zgjerimit të shërbimeve universale në të gjitha zyrat postare, duke i shërbyer komuniteteve në vendin tonë, sipas standardeve të shërbimit të miratuara. Objektivat e treguesve të cilësisë të shërbimit janë arritur nëpërmjet monitorimit të proceseve operacionale të punës në filiale, degë, zyra postare, informatizimit të procedurave për objektet postare, nga pranimi deri në shpërndarjen e objektit, duke gjurmuar të gjitha etapat që ka kryer një objekt postar gjatë proceseve operacionale të punës, për rrjedhojë të gjitha këto masa përmirësuan standardet e shërbimit universal postar.



Monitorimi në kohë reale i transportit të dërgesave postare sipas grafikëve të grumbullimit të dërgesave postare në të gjitha linjat, rritja e elementëve të sigurisë në proceset operacionale të punës, në zyra postare, sektorë përpunimi, mjete transporti si dhe investimet në përmirësimin e

logjistikës në fokusin e realizimit të standardit të brendshëm D+1, kanë rritur besimin që Posta Shqiptare gjithmonë do të jetë në shërbim të klientit me cilësi, siguri dhe shpejtësi të garantuar .

Realizimi vjetor i treguesve të performancës së cilësisë së shërbimit universal postar për vitin 2019.


Treguesit e performancës së cilësisë së shërbimit universal postar për vitin 2019, të grupuara sipas standardeve të shërbimit paraqiten si më poshtë vijon :

- ✓ Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar **brenda qytetit** për vitin **2019** është realizuar **96.5% në D+1** nga 95.0 % që është standardi i miratuar.




- ✓ Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar **ndërmjet qyteteve** për vitin **2019** është realizuar **95.3% në D+1** nga 85.0 % që është standardi i miratuar.

Grafiku realizimit të performancës ndërmjet qyteteve Kompania vjetore 2019




Grafiku realizimit të performancës ndërmjet qyteteve sipas Filialeve vjetore 2019




- ✓ Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar **ndërmjet fshatrave** për vitin **2019** është realizuar **80.9% në D+2** nga 60.0% që është standardi i miratuar.

Grafiku realizimit të performancës ndërmjet Fshatrave
Kompania vjetore 2019



Grafiku realizimit të performancës ndërmjet fshatrave sipas Filialeve vjetore 2019



IV.3. MONITORIMI KRITEREVE TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Bazuar në nenin 60 e vijues të Ligjit Nr. 46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, (ligji Nr. 46/2015), nenin 45 të ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe Rregulloren Nr. 45, datë 27.10.2016 “Metodikë Inspektimi i veprimtarisë së ofruesve të Shërbimeve Postare”, AKEP ka kryer çdo vit inspektimet pranë Posta Shqiptare SHA “Për Ofruesin e Shërbimit Universal Postar”.

Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Rezolutën nr. 1735/3 prot., datë 03.06.2019, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018”, ka përcaktuar disa Rekomandime sipas të cilave AKEP si autoritet i pavarur dhe mbikëqyrës në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare duhet:

- *Të kërkojë me rigozitet nga Posta Shqiptare SHA dorëzimin e pakove (dërgesave) në adresën e individit, si një kërkesë ligjore, zbatimin e së cilës duhet të përmbushet brenda një kohe sa më të shkurtër, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.*

- *Të marrë masa, brenda vitit 2019, që qytetarët (konsumatorët) të mos paguajnë tarifa dhe kosto shtesë për marrjen e pakove (dërgesave) nga Posta Shqiptare SHA, praktikë sipas të cilës qytetarët duhet të shkojnë ta tërheqin pakon (dërgesën) në zyrat e postës kundrejt një pagese, në vend që ta marrin në adresë pakon (dërgesën).*
- **Lidhur me rekomandimet e AKEP për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40 të Ligjit 46/2015, brenda vitit 2019;**

Manuali i Konventës së UPU-së në Nenin 17-205 (Procedurat e Shpërndarjes) citon: *“Si rregull i përgjithshëm, pakot u dorëzohen të adresuesve sa më shpejt të jetë e mundur dhe sipas dispozitave në fuqi në vendin e destinacionit. Kur pakot nuk dorëzohen në adresën e marrësit, nëse kjo është e pamundur, marrësi do të njoftohet për ardhjen e tyre pa vonesë”*, ndërsa legjislacioni vendas duke iu referuar citimit të mësipërm, Neni 40, i Ligjit Nr. 46/2015 citon : *“Objektet poastare dorëzohen në njërin nga këto adresa të marrësit:*

- a) *në banesën e tij;*
- b) *në ambientet e punës ose biznesit;*
- c) *në kutinë postare të vendosur në ambientet përkatëse”.*

Pra, në përmbushje të detyrimeve të kryerjes së shërbimit universal postar, “Posta Shqiptare” SHA ka detyrimin e shpërndarjes në adresë të objekteve postare. Për shkak të

- 1) vështirësive të gjetjes së adresave, sepse
 - sistemi nuk është i identifikueshëm saktë dhe mungon infrastruktura; dhe
 - në shumë raste jepet vetëm një element adrese
- 2) pamundësisë tekniko/logjistike

“Posta Shqiptare”sh.a, si dhe disa ofrues të tjerë të shërbimit postar, nuk dorëzojnë në adresë objektet e kolipostës. Ky fakt është evidentuar nga AKEP gjatë inspektimeve të kryera për ofruesin e shërbimit universal postar. Në zbatim të detyrave të lëna nga AKEP pas inspektimeve të viteve 2017 dhe 2018, “Posta Shqiptare” SHA. gjatë muajit Dhjetor 2019, filloi dorëzimin në adresë edhe të pjesës tjetër të paketave të vogla dhe kolipostare.

Në funksion të realizmit të këtij shërbimi, bazuar në deklaratimet e “Posta Shqiptare” SHA u investua me kosto të konsiderueshme nga ofruesi i shërbimit universal për fuqizimin e flotës së transportit me blerjen e 21 furgoncinave dhe 30 motoçikletave, të cilat janë shpërndarë në të gjitha filialet e postave. Drejtoria e Shërbimeve Postare, po monitoron procesin e shpërndarjes dhe

alokimit të fuqisë punëtore, nga ku rezulton se aktualisht në nivel kompanie rreth 15% e objekteve shpërndahen në adresë.

- **Lidhur me marrjen e masave mbi rishikimin e Vendimi Nr. 05, datë 30.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare.**

Posta Shqiptare sqaron se në disa raste është përpjekur të heqë tarifatat e dorëzimit për kolipostat dhe paketat e vogla, të cilat janë tarifa të miratuara nga organet vendimmarrëse të Postës Shqiptare SHA dhe të pandryshuara prej vitit 1999 (VKM Nr. 454., datë 23.09.1999). Këto tarifa janë aplikuar për të mbuluar pjesërisht kostot e këtij shërbimi në vite. Në kushtet e investimeve që ka bërë se fundmi Posta Shqiptare SHA në flotën e transportit, rritjen e kostove operacionale për këtë shërbim si dhe rritjen e numrit të korrierëve të dedikuar në funksion të dorëzimit në adresë të paketave dhe kolipostave, heqja e aplikimit të kësaj tarife e cila është e programuar edhe në buxhetin e vitit 2020 bëhet akoma më e vështirë edhe për shkak të impaktit që do të sjellë në fitimin e kompanisë mungesa e të ardhurave nga vjelja e kësaj tarife.

Megjithatë, në lidhje me këtë pikë, në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit për vitin 2019, AKEP i rekomandon “Posta Shqiptare” SHA marrjen e masave për rishikimin e Vendimit Nr. 05, datë 30.01.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare dhe rishikimin e Vendimit nr. 24, datë 17.06.2014, “Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimeve postare të Shoqërisë Posta Shqiptare SHA” (*shërbimi i lajmërimit për tërheqjen e pakove postare*), me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare.

- **Lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 31 të Ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 date 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”**

Për plotësimin e kësaj kërkesë ligjore “Posta Shqiptare” SHA ka sqaruar se është në proces për t’i dhënë një zgjidhje kësaj çështjeje, dhe AKEP në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit për vitin 2019, të sipërcituar i rekomandon “Posta Shqiptare” SHA marrjen e masave për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore dhe teknike me qëllim plotësimin e kërkesave të nenit 31 të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

V. Vlerësimi ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal postar

AKEP-i me anë të këtij dokumenti ka kryer procesin e rishikimit të parë për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, dhe në këtë dokument AKEP ka analizuar nëse në treg ekziston më shumë se një operator që plotëson kushtet ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin.

Baza ligjore dhe rregullative për analizën e tregut dhe vlerësimin e numrit të ofruesve të mundshëm të shërbimit postar

Sipas VKM Nr. 239, datë 2.5.2018 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN E OFRUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR përcaktohen rregullat për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar me konkurrim publik si dhe përcaktimin e zonës minimale për ofrimin e shërbimit universal postar.

Përcaktimi i ofruesit/esve të shërbimit universal postar bëhet me vendim të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), bazuar në parimet e:

- a) objektivitetit;
- b) transparencës;
- c) mosdiskriminimit;
- ç) proporcionalitetit.

Në përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, AKEP-i garanton vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit universal postar si dhe siguron trajtimin e barabartë të përdoruesve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të përmbushë kërkesat ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit postar, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Për sigurimin e shërbimit universal postar, AKEP-i ka të drejtë të caktojë:

- a. një ose më shumë ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b. ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për sigurimin e elementeve të veçanta të një shërbimi universal postar, nëse është e përshtatshme me kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen;
- c. ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për mbulimin e zonave të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut


postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezulton që këto shërbime nuk ofrohen në zonën përkatëse.

V.1 KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E OFRUESIT TË SHËRBBIMIT UNIVERSAL POSTAR

Në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar, AKEP-i në veçanti merr në konsideratë:

- rrethanat dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe nevojën e zbatimit të shërbimit universal postar;
- aftësitë teknike, përfshirë sistemin e informacionit për ndjekjen e objekteve postare, aftësitë financiare dhe besueshmërinë e ofruesit për sigurimin e shërbimit universal postar në një zonë të caktuar ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të përcaktuar;

Grafik 36. Treguesit teknik dhe të rrjetit për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



c. pikat e aksesit të rrjetit postar të ofruesit të shërbimit universal postar;

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të pikës 7 te nenit 6 dhe pikes 3 te nenit 12 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", si dhe, bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, me urdhërin Nr. 469, datë 27, 12, 2019, ka vendosur "Për përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar".


Me anë të urdhërit është bërë përcaktimin e dëndësisë së pikave të aksesit të rrjetit postar për ofrimin e shërbimit universal postar, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë,

Numri i pikave të aksesit në nivel kombëtar duhet të jetë i tillë, që të sigurojë se:

- a) **Një zyrë postare t'i ofroje shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej 5,500 banorë;**

Nga të dhënat statistikore të dhjetor 2019 rezulton se përveç Postës Shqiptare asnjë subjekt tjetër i shërbimeve postare nuk i plotëson kriteret për të patur një zyrë postare për 5.500 banorë. Bazuar në të dhënat e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011⁵, rezulton se popullsia e Shqipërisë ishte 2,831,741 banorë dhe për çdo subjekt postar që kërkon të ofrojë shërbimin universal duhet të ketë të paktën 514 zyra postare.


Grafik 37. Treguesit teknik të rrjetit Posta Shqiptare vs.Ofruesit e tjerë



Sipas tabelës së të dhënave statistikore për tremujorin e katërt 2019 mbi treguesit teknikë të rrjetit të Postës Shqiptare dhe ofruesve të **tjerë rezulton se ky kriter plotësohet vetëm nga ana e Postës Shqiptare e cila aktualisht ka 559 zyra të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë.**

Grafik 38. Treguesit teknik të rrjetit për çdo ofrues të shërbimeve postare

⁵ http://ëëë.instat.gov.al/media/3057/instat_paraprake.pdf




b) Të ketë një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej 53 km

Zyrat postare (të SHU) janë pika aksesit që ofrojnë pranimin e të gjitha llojeve të objekteve postare, pjesë e objektit të Shërbimit Universal. Në çdo zyrë postare duhet të ketë të paktën 1 (një) kuti postare që shërben për pranimin e objekteve të thjeshta postare sipas përcaktirneve në rregulloret e UPU-së.

Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit duhet të jetë mesatarisht 5 km. Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit, duhet të jetë mesatarisht 8 km për të paktën 95% të popullsisë. Përcaktimi zonë urbane dhe zonë rurale mbështetet në klasifikimin e përdorur në Census 2011.

AKEP ka publikuar hartën e mbulimit me shërbim nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar POSTA SHQIPTARE me 559 zyra postare për të mbuluar me shërbim gjithë zonat gjeografike.

Grafik 39. Të ardhurat nga Posta Shqiptare, viti 2019



- d. kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit që mund të kërkohet nga operatori për ofrimin e shërbimit universal postar.

AKEP konkludon se kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar nuk janë llogaritur dhe paraqitur në AKEP nga Posta Shqiptare SHA sipas kërkesave të nenit 31 të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr. 41 datë 03.03.2016 “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”. Për pasojë edhe nëse do të pretendohet kompensimi nga Posta Shqiptare, nuk mund të kërkohet vlerë korresponduese kompensimi në mungesë të kostove përkatëse neto të ofrimit të shërbimit universal.

VI. Përfundime

Këshillit Drejtues i AKEP me vendimin Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur ofruesin “Posta Shqiptare sh.a”, me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjet nga hyrja në fuqi e vendimit. Sipas përcaktimeve të VKD 2581/2015 të AKEP, afati i përfundimit të autorizimit individual të Posta Shqiptare për shërbimin universal postar përfundon më 7 Korrik 2020.

Nga analiza rezulton se Posta Shqiptare Sh.A i ka përmbushur detyrimet për ofrimin e shërbimit universal të cilat në mënyrë periodike i ka raportuar pranë AKEP. AKEP ka monitoruar çdo vit nëpërmjet inspektimeve realizimin e detyrimeve për ofruesin e shërbimit universal. Burimi kryesor i të ardhurave të Postës Shqiptare sa i përket shërbimit postar (pa përfshirë të ardhurat nga shërbimet financiare) është shërbimi universal postar me mbi 79% pjesë tregu, i ndjekur nga shërbimi ekspres dhe shërbimi jo universal postar.

Në zbatim të pikës 7 te nenit 6 dhe pikës 3 te nenit 12 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", si dhe, bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar, me urdhërin Nr. 469, datë 27, 12, 2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur “Për përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar ”.

Sipas të dhënave statistikore për vitin 2019 mbi treguesit teknikë të rrjetit të Postës Shqiptare dhe ofruesve të tjerë rezultoi se ky kriter plotësohet vetëm nga ana e Postës Shqiptare e cila aktualisht ka 559 zyra të shpërndara në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë.

Si konkluzion nga analiza përfundimtare rezultoi se në treg ka vetëm një operator, Posta Shqiptare Sh.A që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin.

Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal postar me procedurën e konkurrimit publik do të bëhej vetëm nëse në përfundim të analizës së zhvillimit të tregut të kryer nga AKEP-i konstatohej që kishte, të paktën, dy ofrues të shërbimeve postare, të cilët mund të sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Meqënëse Posta Shqiptare Sh.A është operatori i vetëm që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, AKEP-i do të miratojë zgjatjen e afatit të autorizimit individual të operatorit ekzistues për sigurimin e shërbimit universal postar dhe do të lëshojë autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Aneks 1- Pyetjet e Këshillimit Publik

AKEP ishte i interesuar të merte komente nga palët e interesuara brenda afatit 30 ditor të këshillimit publik por vetëm Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ju përgjigj me shkresën nr. 3557/1 të datës 14.05.2020 ku shprehet se “pas shqyrtimit të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”, vëren se janë analizuar në tërësi të gjithë aspektet e tregut të shërbimeve postare duke u shprehur parimisht dakord me përmbajtjen e dokumentit.

1. A janë pasqyruar drejt zhvillimet dhe trendet e tregut postar dhe shërbimit universal postar në Shqipëri?
2. Cili është opinioni juaj në lidhje me performancën e Posta Shqiptare sh.a në ofrimin e shërbimit universal postar në lidhje me:
 - a. Mbulimin me shërbim të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - b. Nivelin e tarifave dhe përballueshmërinë, orientimin në kosto të tyre;
 - c. Cilësinë e ofrimit të shërbimit universal postar?
3. Cili është opinioni juaj në lidhje me problematikat e evidentuara nga AKEP për shërbimin universal postar dhe shërbimin postar në tërësi dhe sugjerimet tuaja për adresimin e tyre?

4. Sa operatorë postar plotësojnë kriteret teknike-logjistike-ekonomike për të ofruar shërbimin universal postar në të gjithë territorin e RSH sipas përcaktimeve të Ligjit 46/2015 dhe akteve nën-ligjore të tij?
5. Cilat mendoni se janë aspektet kryesore ku duhet të fokusohet puna e AKEP me qëllim rritjen e përdorimit dhe përfitimeve të konsumatorëve dhe bizneseve për shërbimet postare në Shqipëri?